



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1021/20 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

VENDIM

Nr.256, datë 29.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 129, DATË 09.06.2017,
NË INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 129, datë 09.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike në datën 08.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjësës *****”,

KONSTATOVA SE:

Në datën 08.06.2017, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë regjistruar informacionet me nr. 3830/1 prot. dhe nr. 3817/1 prot., dërguar respektivisht nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të nëpunësës *****, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Drejtësisë. Komisioneri për këtë rast ka filluar hetimin administrativ, gjatë të cilit ka shqyrtuar dhe administruar gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr.129, datë 3.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike, në datën 08.06.2017 , në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjësës *****”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikat 1 dhe 2 të të cilit është vendosur:

1. *Të kërkoj nga Ministri i Drejtësisë, që për të rregulluar situatën e ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të anulojë Urdhrin nr.3817, datë 08.06.2017, “Për pezullimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe marrjen e masave për dorëzimin e detyrës”, si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, duke rikthyer në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Drejtësisë punonjësen *****.*
2. *Departamenti i Administratës Publike të vijojë procedurën e nisur për verifikimin e kushteve të pezullimit për punonjësen ***** dhe të finalizojë procesin me vendimin përkatës.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 129, datë 09.06.2017, me shkresën nr. 1836 prot., datë 30.11.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit Nr. 129, datë 09.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike në datën 08.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjëses *****”, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Migena Haznedari, Specialist pranë kësaj drejtorie, të cilët në datën 01.12.2017, u paraqitën në insitucionin e Ministrisë së Drejtësisë.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin paralajmëruar. Dokumentacioni shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 01.12.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë.

Pasi u administruan dhe utrajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikat 1 dhe 2 të vendimit paralajmëruar, Komisioneri ka kërkuar nga Ministri i Drejtësisë që për të rregulluar situatën e ligjshmërisë, të anulojë Urdhrin nr.3817, datë 08.06.2017, “Për pezullimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe marrjen e masave për dorëzimin e detyrës”, si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, duke rikthyer punonjësen në fjalë në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Në datën 11.06.2017, pranë DAP është përcjellë shkresa Nr. 3817/10 Prot., e Ministrit të Drejtësisë, në të cilën kërkohet pezullimi i nëpunëses ***** deri në përfundimin e hetimit administrativ nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes.

Nëpërmjet shkresave Nr. 3817/7 Prot., datë 21.06.2017 dhe Nr. 3817/9 Prot., datë 05.07.2017, drejtuar DAP është kërkuar fillimi i ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses *****.

Me shkresën Nr. 4657 prot, datë 17.07.2017, të DAP, Ministri i Drejtësisë është vënë në dijeni se me Vendimin Nr. 45, datë 14.07.2017, Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore ndaj kësaj nëpunëseje.

Më tej, me shkresën Nr.4195/4 prot, datë 17.07.2017, “Njoftim për pezullim nga detyra”, të Departamentit të Administratës Publike, drejtuar nëpunëses ***** , kjo e fundit është vënë në dijeni se Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, me Vendimin nr.46, datë 14.07.2017, ka vendosur pezullimin e saj deri në përfundim të hetimit administrativ dhe marrjes së një vendimi përfundimtar.

Në përfundim të hetimit administrativ, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 4657/20, datë 06.10.2017, ka përcjellë pranë Ministrin të Drejtësisë Vendimin Nr.6, datë 06.10.2017, të DAP, mbi përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të ***** , marrë në zbatim të Vendimit Nr.66, datë 05.10.2017 të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes.

Nga verifikimi në subjekt, rezultoi se me fletëthirrjen Nr.Akti 5212, datë 31.10.2017, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është depozituar kërkesëpadia me palë dhe objekt si më poshtë:

Paditës: *****

I Paditur : 1- Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND pranë DAP

2- Departamenti i Administratës Publike

3- Ministria e Drejtësisë

Objekti i padisë: 1. Shfuqizimin e aktit administrativ Vendimit nr.66, datë 05.10.2017, të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND “Për largimin nga shërbimi civil të *****...”. 2. Kundërshtimin e Vendimit nr.45, datë 14.07.2017, për pezullimin nga detyra të *****... 3.Kthimin e paditëses në pozicionin e mëparshëm të punës...

Në këto kushte, bazuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i RSH”, në të cilin përcaktohet se institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 129, datë 09.06.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike, në datën 08.06.2017, në lidhje me pezullimin nga shërbimi civil të punonjësës *****”.*
2. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha